



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Sesioni vjeshor

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
për Persona të Pagjetur dhe Peticione

P-nr.29/2018

Prishtinë, më 10 shtator 2018

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Duda Balje, Lirije Kajtazi, Mexhide Mjaku-Topalli, Saranda Bogujevci, Teuta Haxhiu dhe Fisnik Ismaili.

Munguan: Sasha Milosavljeviq, Mirjeta Kalludra, Luljeta Veselaj-Gutaj, Shemsi Syla, dhe Albulena Balaj- Halimaj.

Stafi mbështetës i komisionit: Selman Ymeri, koordinator dhe Sulltane Gashi, zyrtare e fushës.

Pjesëmarrës të tjerë: Lina Ingelstam, drejtoreshë e programeve ndërkombëtare, Save the Children, Suedi, Paola Castro Neidestram, udhëheqëse e departamentit për zhvillim, Save the Children, Suedi, Mie Melin, drejtoreshë e fushës tematike, Save the Children Suedi, Ahmet Kryeziu, drejtor Save the Children Kosovë, Kanarina Shehu, specialiste tematike për mbrojtjen e fëmijës, Melita Kabashi, koordinatorë për avokim dhe fushatë, Mehmet Krasniqi, Ekonomia Online dhe Xhemajl Kuliqi-KDI.

Mbledhjen e kryesoi, Duda Balje, kryetare e komisionit.

Anëtarët e komisionit nuk patën vërejtje dhe as propozime të tjera për rendin e ditës, të propozuar nga kryetarja e komisionit, andaj komisioni i zhvilloi punimet me këtë

Rend dite:

1. Takim në Komisionin FunkSIONAL me delegacionin e udhëhequr nga znj. Lena Ingelstam, drejtoreshë e Programeve Ndërkombëtare të Save the Children në Suedi;

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara;

3. Të ndryshme.

1. Takim në Komisionin Funkcional me delegacionin e udhëhequr nga znj. Lena Ingelstam, drejtoreshë e Programeve Ndërkombëtare të Save the Children në Suedi

Kryetarja, fillimisht, u dëshiroi mirëseardhje delegacionit të Save the Children nga Suedia dhe vlerësoi përkrahjen e vazhdueshme që po bëjnë për Komisionin Funkcional, lidhur me Projektligjin për mbrojtjen e fëmijës.

Ajo njoftoi mysafirët se komisioni e ka miratuar në parim dhe i ka rekomanduar Kuvendit të Kosovës miratimin në lexim të parë, e pastaj do të japim kontributin si komision që të kemi një ligj të mirë dhe të zbatueshëm.

Më pas, ajo foli edhe për aspekte të tjera të ndërlidhura me tekstin e Projektligjit për mbrojtjen e fëmijës, me theks në mbrojtjen e fëmijëve nga përdorimin i Internetit, si dhe u interesua që praktikat më të mira për këtë çështje t'i inkorporojmë edhe në këtë projektligj, gjatë fazës së amendamentimit.

Saranda Bogujevci tha se Projektligji për mbrojtje e fëmijës është në Kuvend për lexim të parë dhe pas miratimit në parim kemi mundësi me bërë ndryshime dhe të kemi një ligj sa më të mirë dhe në interes të mbrojtjes së fëmijëve. Më tej theksoi se kemi ligje të mira por problem është zbatimi i ligjeve, nuk është problem vetëm buxheti, por edhe aspektet tjera dhe se edhe në shtetet e zhvilluara ka marrë kohë ndryshimi, por ne do të punojmë dhe do të organizojmë edhe fushata promovimi dhe besojmë se në këtë drejtim do të ja arrijmë qëllimit.

Mexhide Mjaku-Topalli falënderoi për mbështetjen që e bëjnë për komisionin, si legjislatoren e kaluar po ashtu edhe tani për trajnimin për disiplinën prindërore pozitive dhe mbështetjen e vazhdueshme sa i përket projektligjit për mbrojtjen e fëmijës. Unë qëndroj mbrapa asaj që të jenë shtëpitë model që i kemi parë në Suedi, tha se është mirë me pa ndonjë praktikë se si ndonjë vend tjetër ka eliminuar dukurinë e keqpërdorimit të internetit nga fëmijët, po ashtu temë me rëndësi është edhe afrimi i shërbimeve ndaj fëmijëve me aftësi të kufizuara, dhe po ashtu edhe gjatë shqyrtimit dhe amendamentimit të projektligjit për mbrojtjen e fëmijës mundeni me na afrua mbështetje që të bëjmë një ligj sa më të mirë.

Teuta Haxhiu falënderoj mysafirët nga Save the Children për takimin dhe mbështetjen e vazhdueshme, tha se e keni një staf shumë të mirë në Kosovë, dhe se kërkojmë të na ndihmoni që të bëjmë një ligj sa më të mirë dhe të zbatueshëm për mbrojtjen e fëmijës, tha se me insistimin e saj dhe të kolegëve kuvendi ka mbajtur një debat parlamentare për qasjen e fëmijëve në internet janë edhe disa rekomandime por është mirë me i parë edhe përvojat e vendeve të tjera se çka mundemi me bërë në këtë fushë edhe në këtë ligj.

Fisnik Ismaili tha se sa i përket projektligjit për mbrojtjen e fëmijës do të jap mbështetjen time dhe sa herë që mundem do të jem prezent dhe besoj se do të bëjmë një ligj të mirë, kemi nevojë të kemi përkrahje sidomos në implementim të ligjit sepse kjo do të jetë një sfidë e madhe.

Lena Ingelstam tha se falënderon anëtarët e komisioni që kanë gjetur kohë për takimin, tha se nesër do të jenë në vizitë në qytetin e Prizrenit lidhur me funksionimin e mbrojtjes së fëmijëve

dhe është mirë ju të ngrehni çështje të ndryshme që kanë ndikim në mbrojtjen e fëmijës, dëgjuam për hapat që i ka bërë komisioni për ligjin për mbrojtjen e fëmijës, po ashtu për çështjet që u ngritën për sigurinë e fëmijëve në internet, por kisha pasur dëshirë të dija edhe pikëpamjet e juaja rreth ndalimit të ndëshkimit trupore e që është pjese e projektligjit.

Mie Melin: Ju inkurajoj në përpjekjet që jeni duke i bërë që të avanconi me ligjin për mbrojtjen e fëmijës. Ajo tha se ndalimi i ndëshkimit trupor nuk ka qenë proces i lehtë as për Suedinë e cila për 20 vite është dashur me diskutuar, lidhur me çështjen e sigurisë së fëmijëve në internet kishim pasur dëshirë me dëgjuar më shumë pikëpamjet e juaja në këtë aspekt dhe me pa se si ne kishim mundur me ju ndihmuar rreth adresimit të kësaj teme.

Lirije Kajtazi tha se legjislaturën e kaluar ky projektligj pati kaluar të gjitha procedurat, por për shkak të shpërbërjes së Kuvendit dhe shkuarjes në zgjedhje ka mbetur pa u miratuar dhe se ajo që ka ndikuar me mbetur më gjatë në procedurë ka qenë kostoja buxhetore e ligjit e cila edhe i jep jetë ligjit, dhe tani e kemi në procedurë përsëri dhe besoj që do ta shqyrtojmë me kujdes dhe do të japim maksimumin që të kemi një ligj të mirë dhe të zbatueshëm për të mirën e fëmijëve dhe i intereson të dija se shtëpitë e fëmijëve a duhet me qëndrua edhe në nivelin lokal edhe qendror.

Mie Melin tha se shtëpitë e fëmijëve administrohen në nivelin lokal dhe për Suedinë fillimisht ka qenë si pilot- projekt që me i tregua komunitetit përfitimet që fëmijët i marrin gjatë funksionimit të saj.

Ahmet Kryeziu tha se falënderon komisionin për pritjen dhe është me interes për Save the Children që të ju përkrahim në këto procese të rëndësishme dhe sidomos për ligjin për mbrojtjen e fëmijës, por njëkohësisht dhe ne jemi bashkë me shoqërinë civile me organizatat lokalet e të diskutojmë për çështjet e fëmijëve, dhe bashkërisht deri më tani çdo përkrahje që kemi dhënë ka qenë e bashkërenduar me zërat e organizatave lokale janë dëgjuar dhe faleminderit që janë marrë parasysh dhe jemi në rrugë të mirë dhe do ta keni përkrahjen tonë në këtë proces, dhe besoj se do të jemi bashkë edhe në implementim të këtij ligji.

Kryetarja, në fund të këtij takimi, falënderoj mysafirët nga Save the Children për bashkëpunimin dhe përkrahjen e vazhdueshme ndaj komisionit, konkretisht për Projektligjin për mbrojtjen e fëmijës dhe temat që u ngritën në këtë takim dhe tha se beson se ky bashkëpunim do të vazhdojë edhe në të ardhmen.

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara

Kryetarja konstatoi se komisioni miratoi pa vërejtje procesverbalet e mbledhjeve të mbajtur më 21 qershor dhe 11 korrik 2018.

3. Të ndryshme.

Komisioni vendosi që mbledhjen e radhës ta bëjë rishikimin e Planit të Punës për sesionin vjeshtor 2018, si dhe të vendoset dita se kur të bëhet vizita në kompleksin memorial në Meje të Gjakovës.

Komisioni vendosi që mbledhjen e radhës ta mbajë më 17 shtator 2018, në orën 10:00.

Mbledhja përfundoi në orën 15:30.

E përgatiti:
Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetarja e komisionit,

Duda Balje